# FOTO/ Kapsolle dhe fishekzjarrë me fuqi të lartë shpërthyese në bagazhin e makinës, procedohet penalisht 59-vjeçari në Durrës

31 Dhjetor, 2020 16:35 | 1 497 shfletime



Madhësia e tekstit:

**MAMINAS**

Policia e Shtetit informon se ka sekuestruar kapsolle dhe fishekzjarrë, që ndodheshin në bagazhin e një makine, në Maminas.

Sipas policisë, është proceduar penalisht një 59-vjeçar, për posedim të mjeteve piroteknike.



**Njoftimi i policisë:**

Durrës

Policia e Durrësit kontrrolle të shtuara për parandalimin e tregtimit të lëndëve piroteknike.

Sekuestrohen në Maminas,  72 pako fishekzjarrë me fuqi të lartë shpërthyese, të rrezikshme për jetën e qytetarëve gjatë përdorimit të tyre.

Procedohet penalisht tregtuesi i tyre.

Strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, kanë shtuar masat për parandalimin e hedhjes në treg të lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve për përdorimin civil, që rrezikojnë sigurinë publike, jetën dhe shëndetin e qytetarëve.

Si rezultat i kontrolleve, në Maminas shërbimet e Policisë kanë konstatuar shtetasin N. Gj., i cili në bagazhin e makinës disponónte 72 pako me fishekzjarrë të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Në përfundim të veprimeve nga Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Shijak, u procedua për veprën penale "Tregtimi dhe transportimi i mallrave kontrabandë", shtetasi N. Gj., 59 vjeç, banues në Maminas.

Kontrollet do të vijojnë në të gjith territorin e Durrësit dhe në këtë kuadër Policia Durrës fton qytetarët që të denoncojnë në numrin 112 dhe Komisariatin Dixhital çdo rast të tregtimit apo përdorimit të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve duke ju garantuar ruajtje anonimati dhe reagim të shpejtë.

**(d.xh/ Balkanweb)**

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

**Etiketa:** fishekzjarre kapsolle maminas

Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT

Gjithçka që ndodhi në Kongresin Amerikan: Nga kaosi, bombat, deri tek reagimet e ndryshme (FOTO+VIDEO)
07 Janar, 2021

Dhuna në Capitol, kryebashkiaku i Uashington D.C. zgjat gjendjen e emergjencës me 15 ditë: Trazirat mund të vijojnë
07 Janar, 2021

Pamje të rënda/ Ja momenti kur gruaja qëllohet me armë nga policia brenda Kongresit Amerikan
07 Janar, 2021

U hodh në ujë për të marrë kryqin, përplaset në shkëmb, rrezikon shtyllën kurrizore. Orë kritike për 25-vjeçarin në Greqi (VIDEO)
07 Janar, 2021

Kaosi në Capitol, dorëhiqen shefja e stafit të Zonjës së Parë dhe Sekretarja Sociale e Shtëpisë së Bardhë
07 Janar, 2021

Protesta me 4 viktima në SHBA, reagon ish-ministri i Brendshëm Sandër Lleshaj
07 Janar, 2021

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALERR

@balkanweb

TË NGJASHME

Nën masa pandemie troket Viti i Ri 2021, sheshi "Skënderbej" i boshatisur, festa vjen me spektakël fishekzjarrësh
Erjola Jata | 01 Janar, 2021

Tregtonin fishekzjarre, policia e Durrësit ndjekje penale për 3 të rinj dhe një 52-vjeçar
01 Janar, 2021

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

"Është flamë"! Zbulohet mesazhi i fundit i Kujtim Prodanit, çfarë i tha Akademikut më 31 dhjetor
06 Janar, 2021

Ministri Çuçi takohet me homologun turk: Të krijojmë një klimë më të ngushtë bashkëpunimi në luftën kundër trafiqeve e terrorizmit
06 Janar, 2021

"Na shkatërrove këtë fillim vit", Shpëtim Saraçi: Mos o Kujte se nuk mbajmë dot më! Po më dridhen duart
06 Janar, 2021

"Gjetsh paqe atje ku je"! Genc Pollo fjalë të ndjera për Kujtim Prodanin: Ishe gjithmonë i qeshur, siç të njoha që në klasë të parë
06 Janar, 2021

"Tallesh ti?!" Redon Makashi tregon si e mësoi humbjen e Kujtim Prodanit: E pabesueshme, nuk e imagjinoj dot!
06 Janar, 2021

Aksidentet/ Policia Rrugore monitorim në të gjitha rrugët e vendit, në 6 ditët e para 22 shoferë në pranga, 3290 gjoba
06 Janar, 2021

KATEGORIA VIDEO

Gjithçka që ndodhi në Kongresin Amerikan: Nga kaosi, bombat, deri tek reagimet e ndryshme (FOTO+VIDEO)
07 Janar, 2021

U hodh në ujë për të marrë kryqin, përplaset në shkëmb, rrezikon shtyllën kurrizore. Orë kritike për 25-vjeçarin në Greqi (VIDEO)
07 Janar, 2021

VIDEO/ Momenti kur protestuesit thyejnë kordonin policor dhe futen në Kongres
06 Janar, 2021

Kaosi në Uashington DC/ Sokol Balla nga SHBA: Orë të errëta për vendin, Trump mund të nxjerrë ushtrinë në rrugë
06 Janar, 2021

Projekti i rrugës Vlorë-Orikum/ Presidenca: Asnjëherë nuk është vonë, Denaj e Rama të përmbushin detyrimet, të mos krijojnë vonesa për investimet
06 Janar, 2021

Dokument/ 30 milionë euro për 5 vjet, përpunimi i kontejnerëve në portin e Durrësit i jepet me koncesion kompanisë malteze
06 Janar, 2021



© 2021 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.